R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1170/4 prot. Tiranë, më 13.11.2026

V E N D I M

Nr.49, datë 13.11.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Ankuesi, qendra "Res Publica", përfaqësuar nga z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularët e ankesave nr. 1170 prot., datë 27.04.2026, nr. 1444 prot. dhe nr. 1445 prot., datë 26.05.2026, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, me anë të kërkesave nr. 43/26 prot., nr. 45/26 prot. dhe nr. 46/26 prot., datë 27.03.2026, depozituar edhe në adresën elektronike @akuk.gov.al, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

Për kërkesën 43/26:

- *kopje të databazës me të dhënat e të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të trajtuara dhe të patrajtuara pranë ose në ujërat larëse.*
- *A janë kryer kontrolle për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta pranë ose në ujëra larëse?*
- *Nëse po, në cilat subjekte dhe kur?*
- *Sa më sipër, ju lutemi na vini në dispozicion kopje të raportit të mësipërm.*

Për kërkesën 45/26:

- *Cili ka qenë plani i masave ose planifikimit të kontrolleve në subjektet e kontrolluara gjatë këtij viti (janar - shkurt)?*

- *Cilat subjekte janë gjobitur?*

Për kërkesën 46/26:

- *Kopje të dokumentacionit që ka shërbyer si bazë për marrjen e vendimit për ngritjen e Grupit të punës me Urdhrin nr. 101, datë 18.10.2023 (propozime, shkresa, analiza paraprake etj.);*
- *Lista e plotë e anëtarëve të grupit të punës dhe funksionet e tyre;*
- *Kopje të dokumentacionit teknik mbi të cilin është bazuar relacioni që dorëzoi grupi i punës, datë 24.10.2023 (analiza, studime, raporte, të dhëna statistikore, inspektime në terren, tabela, të dhëna teknike etj.);*
- *Në momentin e hartimit të relacionit (datë 24.10.2023), a është bërë një vlerësim i situatës për secilën shoqëri ujësjellës kanalizimesh, nëse disponon apo jo impiant trajtimi dhe, në rastet kur ekziston, cili është kapaciteti i tij funksional?*
- *A janë shqyrtuar edhe alternativa të tjera për zgjidhjen e trajtimit të ujërave të ndotura, si p.sh. ndërtimi i impianteve të përbashkëta që mund t'u shërbejnë disa subjekteve njëkohësisht, apo forcimi i sistemit publik ekzistues përmes rritjes së kapacitetit të impianteve (përfshirë edhe mundësinë e kontributit të vetë subjekteve private në këtë drejtim)?*
- *A është kryer ndonjë analizë ekonomike apo mjedisore që ka mbështetur zgjedhjen e modelit të impianteve individuale për çdo subjekt? Nëse po, a ekziston një dokument apo vlerësim që trajton ndikimin mjedisor të instalimit të këtyre impianteve në mënyrë të shpërndarë, përfshirë edhe efektin e tyre kumulativ?*
- *A ekziston një përkufizim apo kriter i qartë mbi atë se çfarë konsiderohet "subjekt që ushtron aktivitet pranë ujërave larëse"? Në mënyrë më konkrete, cilat janë parametrat (distanca, natyra e aktivitetit, lidhja me sistemin e kanalizimeve, etj.) që përdoren për të përcaktuar nëse një subjekt klasifikohet si potencialisht ndotës në këtë kuptim, sipas relacionit? A konsiderohen ujëra larës, ujërat e liqenit të Tiranës, lumi Erzen, lumi Vjosë, lumi i Shalës?*
- *A është analizuar përputhshmëria e kësaj ndërhyrjeje me Strategjinë Kombëtare për trajtimin e ujërave të ndotura, të miratuar me VKM-në nr. 448/2023? Nëse po, a ekziston një dokument i shkruar që reflekton këtë analizë?*
- *A keni marrë mendimin e specializuar të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura për ndikimin në mjedis të instalimit të impianteve brenda një zone të mbrojtur?*
- *Çfarë përfaqëson konkretisht numri prej rreth 9,000 subjektesh të sektorit të hoteleri-turizmit të përmendur në relacion? A i referohet ky numër të gjitha subjekteve të regjistruara në këtë sektor në nivel kombëtar, apo vetëm një nënkategorie të tyre?*
- *A disponon grupi i punës një identifikim të saktë të subjekteve që shkarkojnë ujëra të ndotura drejtpërdrejt në ujërat larëse, pa qenë të lidhur me rrjetin publik të kanalizimeve? Nëse po, cili është numri i këtyre subjekteve?*
- *A është kryer një analizë mbi kapacitetin real të këtyre subjekteve (numri i shtretërve, fluksi sezonal, volumet e ujërave të ndotura të gjeneruara), si dhe mbi ndikimin konkret që ato kanë në ndotjen e ujërave larëse?*
- *Gjithashtu, a është analizuar veçmas kapaciteti ndotës i subjekteve të lidhura me rrjetin publik të kanalizimeve, duke pasur parasysh se këto subjekte i nënshtrohen trajtimit kolektiv të ujërave urbane nga sistemi publik?*

- *Nëse këto analiza janë kryer, lutemi të na vihen në dispozicion studimet, të dhënat dhe metodologjitë përkatëse mbi të cilat është mbështetur relacioni. Në të kundërt, lutemi të sqaroni mbi çfarë baze faktike dhe teknike janë arritur përfundimet e paraqitura në këtë dokument.*
- *Duke iu referuar kuadrit rregullator ekzistues për trajtimin e ujërave të ndotura, në veçanti dallimit të bërë ndërmjet shkarkimeve industriale dhe atyre urbane, ku për këto të fundit parashikohet trajtim përmes sistemit publik të kanalizimeve dhe impianteve kolektive:*
  - *Si është reflektuar ky dallim në analizën e grupit të punës dhe në përfundimet e relacionit, në kushtet kur ndërhyrja e propozuar orienton drejt instalimit të impianteve individuale edhe për subjekte që prodhojnë ujëra urbane dhe janë të lidhura me sistemin publik?*
  - *Gjithashtu, a është vlerësuar në këtë kontekst nëse kjo qasje përbën një devijim nga modeli i trajtimit kolektiv i parashikuar në legjislacionin në fuqi dhe, nëse po, mbi çfarë baze teknike apo mjedisore është justifikuar ky ndryshim?*
- *VKM nr. 177, datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse" parashikon mënyrën e monitorimit dhe vendin e monitorimit ku konkretisht për veprimtaritë industriale (Kreu II), monitorimi bëhet para se ujërat të futen në sistemin publik të kanalizimeve. Ndërsa për ujërat urbane, standardet e ndotjes maten dhe duhen përmbushur pasi ujërat janë mbledhur nga sistemi publik i kanalizimeve dhe përpara se të shkarkohen në trupat ujore pritëse (Kreu III). Duke pasur parasysh këtë parashikim ligjor:*
- *Si është parashikuar të realizohet në praktikë monitorimi i cilësisë së ujërave të ndotura në rastin e impianteve individuale të shpërndara, në kushtet kur ky model krijon një numër shumë të madh pikash të vogla shkarkimi, për të cilat nuk rezulton të jetë përcaktuar një metodologji e qartë monitorimi në kuadrin rregullator ekzistues?*
- *Kopje të listës së subjekteve të kontrolluara deri më tani dhe kriteret mbi të cilat janë përzgjedhur këto subjekte.*

Në mungesë të një përgjigjeje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankimet pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji, konkretisht, urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesave për informacion nr.43/26 prot. dhe nr. 45/26 prot., për sa i përket pikave 2 dhe 4 të kërkesës dhe nr. 46/26 prot., datë 27.03.2026.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesave, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në to, vlerësoi se ankesat përmbushin kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar (në vijim "LDI").

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: *"Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e*

mundur", Komisioneri, nëpërmjet shkresave nr. 1170/1 prot., datë 04.05.2026, nr. 1444/1 prot., datë 01.06.2026 dhe nr. 1445/1 prot., datë 01.06.2026, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesat për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, për ankesën nr. 1170 prot., datë 27.04.2026, brenda datës 11.05.2026 dhe për ankesat nr. 1444 prot. dhe nr. 1445 prot., datë 26.05.2026, brenda datës 05.06.2026.

Në vijim të shkresave së sipërcituara, Autoriteti Publik, nëpërmjet *email*-it të datës 11.05.2026, i ka kthyer përgjigje ankuesit dhe Zyrës së Komisionerit, duke saktësuar se ka vënë në dijeni ankuesin nëpërmjet përgjigjes së datës 30.04.2026, në të cilën shprehet se: *"...Përgjigje ndaj kërkesës suaj për informacion nr. 43/26 prot., datë 27.03.2026... Në vijim të kërkesës suaj për informacion, të paraqitur pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve, me anë të së cilës kërkoni t'ju vihet në dispozicion kopje e databazës me të dhënat e të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të trajtuara dhe të patrajtuara pranë ose në ujërat larëse, informacion se në cilat subjekte janë kryer kontrolle për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta, si dhe raportin përmbledhës të subjekteve për të cilat është marrë masë administrative, ju bëjmë me dije sa më poshtë: Informacioni që përmbajnë këto databaza, përfshijnë të dhëna që në një pjesë të tyre përbëjnë të dhëna personale apo të dhëna tregtare të mbrojtura. Në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale nuk është e mundur vënia në dispozicion e plotë e tyre. Megjithatë, në funksion të transparencës dhe të drejtës për informim mund të vihet në dispozicion informacion i përgjithshëm/statistikor, i cili nuk cenon të dhënat personale apo interesat legjitime të subjekteve, në përputhje edhe me praktikën e ndjekur në korrespondenca të mëparshme midis Qendrës suaj dhe institucionit tonë. Për sa më sipër, lutemi të saktësoni kërkesën tuaj duke identifikuar informacionin që ju kërkoni, pa cenuar të dhëna personale të mbrojtura nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion ju dërgohet në përputhje me nenin 3 dhe nenin 18 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Dokumentet e kërkuara ju përcillen në format elektronik në adresën e email-it të deklaruar, si dhe mund të tërhiqen në kopje të printuar pranë zyrës sonë. Për çdo sqarim të mëtejshëm, mund të kontaktoni Koordinatorin për të Drejtën e Informimit… Përgjigje ndaj kërkesës suaj për informacion nr. 45/26 prot., datë 27.03.2026... Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion me nr. 45/26 prot., datë 27.03.2026, të paraqitur pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve, ju bëjmë me dije sa më poshtë: Për sa kërkohet në pyetjen nr.1, Task Forca pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime ka vendosur gjithsej 14 masa administrative gjatë vitit 2026 për subjektet të gjetura në shkelje të detyrimeve që rrjedhin nga Akti Normativ nr. 8, datë 28.12.2023. Më specifikisht janë vendosur 5 (pesë) gjoba gjatë muajit janar, 3 (tre) gjoba gjatë muajit shkurt dhe 6 (gjashtë) gjoba gjatë muajit mars. Në lidhje me pyetjet nr. 2 dhe nr. 3, nëpërmjet të cilave kërkoni informacion se cili ka qenë plani i masave ose planifikimit të kontrolleve dhe si janë përzgjedhur subjektet e kontrolluara, Task Forca pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve kryen kontrollet ndaj subjekteve të bazuar në programin periodik dhe mujor të inspektimit të hartuar në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit nr. 65, datë 19.04.2024. Ky program hartohet sipas kategorive të subjekteve, në zbatim të fushave dhe prioriteteve të përcaktuara në programin periodik të inspektimit. Kriteret e përzgjedhjes*

së subjekteve të kontrolluara janë bazuar në nivelin e riskut mjedisor, historikun e shkeljeve, informacionin e mbledhur nga inspektoratet përkatëse. Në lidhje me pyetjen nr. 4, ju sqarojmë se informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale të mbrojtura nga ligji nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si rrjedhim nuk mund të përmendim nominalisht subjektet për të cilët është vendosur masë administrative, por një informacion mbi numrin e këtyre masave ju është dhënë në përgjigje të pyetjes së parë. Ky informacion ju dërgohet në përputhje me nenin 3 dhe nenin 18 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Dokumentet e kërkuara ju përcillen në format elektronik në adresën e email-it të deklaruar, si dhe mund të tërhiqen në kopje të printuar pranë zyrës sonë. Për çdo sqarim të mëtejshëm, mund të kontaktoni Koordinatorin për të Drejtën e Informimit... Përgjigje ndaj kërkesës suaj për informacion me nr. 46/26 prot., datë 27.03.2026... Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion me nr. 46/26 prot., datë 27.03.2026, ju bëjmë me dije sa më poshtë: Në lidhje me pyetjet mbi listën e plotë të anëtarëve të grupit të punës, duke qenë se ky informacion përfshin të dhëna personale, ju informojmë se ju nuk keni shpjeguar qartësisht se çfarë synohet të arrihet me këtë informacion dhe si ndihmon ai në veprimtarinë e qendrës suaj lidhur me çështjen konkrete, prandaj nuk mund të vendosim atë në dispozicion. Pyetjet tuaja të parashtruara në vijim të kësaj kërkese për informacion janë të një natyre analizuese dhe studimore që i përkasin një faze të hershme të procesit të miratimit të një akti ligjor apo nënligjor, në rastin konkret të Aktit Normativ nr. 8, datë 28.12.2023. Detyrat e strukturës së Task Forcës pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve janë të përcaktuara në nenin 6 e në vijim të këtij Akti, Rregulloren Teknike dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 65, datë 19.04.2024. Sipas këtyre akteve, detyrat e Task Forcës përfshijnë: 1. Kontrollin në terren për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 4, të këtij akti normativ, nga subjektet përkatëse, veprimtaritë e të cilave prodhojnë ujëra të ndotura pranë ose në ujëra larëse, duke përfshirë kontrollin për: i. vendosjen e impiantit apo sistemit individual të trajtimit të ujërave të ndotura, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë akt normativ dhe me rregulloren teknike, të miratuara me udhëzim të përbashkët; ii. zëvendësimin e gropave septike me impiante apo sisteme individuale për trajtimin e ujërave të ndotura; 2. Mbledhjen e informacionit dhe krijimin e një databaze për të dhënat e të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të trajtuara dhe të patrajtuara pranë ose në ujërat larëse; 3. Evidentimin, në rastet kur ka, të sistemeve të brendshme të kanalizimeve dhe teknologjisë së përdorur për trajtimin dhe largimin e ujërave të ndotura të patrajtuara për të gjitha subjektet që i shkarkojnë pranë ose në ujërat larëse; 4. Marrjen e masave administrative në rastet kur konstatohen shkeljet, sipas këtij akti normativ; 5. Ushtrimin e kontrolleve për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta, pranë ose në ujëra larëse. Për kryerjen e kësaj detyre Task-Forca bashkëpunon me inspektoratet apo strukturat përkatëse që mbulojnë fushën e mbrojtjes së mjedisit, organin që ka licencuar veprimtarinë, inspektoratin sanitar ose inspektoratin bashkiak; 6. Pas kryerjes së inspektimit apo monitorimit të subjekteve që kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare, liqenore, lumore ose fshatrat turistikë, vendosjen e një tabele për trajtimin ose jo të ujërave të zeza në një vend të dukshëm nga publiku, sipas formatit në aneksin I, bashkëlidhur këtij akti normativ; 7. Përgatitjen, në fund të muajit tetor të një raporti për subjektet, për të cilat është marrë masa administrative, sipas këtij akti normativ, dhe propozimin organeve përgjegjëse për

heqjen e licencës, të lejes ose të autorizimit për kryerjen e veprimtarisë ekonomike ndaj subjekteve që nuk kanë plotësuar standardet edhe pas vendosjes së masave administrative. Natyra e këtyre detyrave është qartazi ekzekutive, kompetencat që Task Forca pranë AKUK-së ushtron lidhen me kontrollin e zbatimit të detyrimeve të aktit normativ nga subjektet, marrjen e masave administrative për shkelësit, mbledhjen e informacionit etj., prandaj institucioni ynë nuk ka informacion mbi të gjitha pyetjet tuaja. Gjatë fazës përgatitore, AKUK ka mbështetur monitorimet në terren nga ana e institucioneve inspektuese. Në raportin përfundimtar të AKUK-së, të përgatitur në përfundim të monitorimeve gjatë fazës përgatitore, është konkluduar se: "Gjatë monitorimeve në terren nga ana e Institucioneve Inspektuese në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve është vënë re gjithashtu se pjesa më e madhe e subjekteve tregtare që operojnë strukturat akomoduese gjatë vijës bregdetare nuk zbatojnë kërkesat e legjislacionit mbi trajtimin e ujërave të ndotura dhe shkarkimin e tyre, të cilat paraqesin problematika të ndryshme sa i përket kushteve dhe zgjidhjeve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura, siç janë gropat septike. Gjithashtu është konstatuar që edhe ato subjekte që janë në proces ndërtimi nuk janë duke zbatuar kërkesat e legjislacionit në fuqi për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Nga inspektimet e kryera në subjekte fizike dhe juridike, që ushtrojnë aktivitetin ekonomik dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të patrajtuara pranë ujërave larëse, janë konstatuar mungesa në ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të kanalizimeve të brendshëm për largimin e ujërave të ndotura të patrajtuara deri në kolektor, mungesa në ndërtimin dhe funksionimin e ITUN-eve të nevojshme, në përputhje me kapacitetet përkatëse të trajtimit të ujërave të ndotura të patrajtuara, mungesa e trajtimit të llumrave dhe të lëndëve të ngurta që dalin nga impiantet e trajtimit, shkarkime të pakontrolluara në mjedisin pritës, probleme strukturore të gropave septike që rezultojnë në rrjedhje të pakontrolluar të ujërave të ndotura në mjedis të hapur, etj. Sidomos në sezonin e pikut turistik veror, vërehet ndotje e dukshme mjedisore aty ku zgjidhja teknologjike e largimit të ujërave të ndotura bëhet me anë të gropave septike, për arsye se nuk arrijnë të pastrohen në kohë nga ana e subjekteve të licencuara për evadimin e ujërave të ndotura nëpërmjet mjeteve teknologjike. Nisur nga situata e emergjencës mjedisore e krijuar drejtpërdrejt nga subjektet fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitetin ekonomik duke shkarkuar ujëra të ndotura të patrajtuara në ujëra larës, del i nevojshëm sensibilizimi dhe marrja e masave konkrete nga këto subjekte që të kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e situatës mjedisore, parandalimin e ndotjes në ujërat larës dhe mjedisit prej ujërave të ndotura dhe kufizimin e ndikimit kur ajo ndodh nëpërmjet ndërtimit të sistemeve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura të patrajtuara në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Duke qenë se situata e emergjencës mjedisore e krijuar është mbartur ndër vite dhe nuk ka rezultuar në zgjidhje të qëndrueshme nga institucionet inspektuese në vend, është vlerësuar marrja e masave nëpërmjet këtij Akti Normativ". Në këtë fazë është konkluduar gjithashtu se zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve mbulohen pjesërisht me rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura urbane dhe ITUN-e. Shumica e këtyre zonave ka mungesë rrjeti kanalizimesh për të mbuluar të gjithë zonën e shërbimit, si dhe në ato zona ku rrjeti ekziston ka kapacitete të limituara grumbullimi dhe transportimi të ujërave të ndotura, duke shkaktuar në vazhdimësi shkarkime të pakontrolluara në mjediset pritëse. Në këto zona janë në operim 8 ITUN-e, me kapacitet të limituar trajtimi prej rreth

vetëm 24% të ngarkesës totale të ndotjes të gjeneruar nga ujërat e ndotura urbane, në shkallë kombëtare. Kapaciteti aktual nuk mund të përballojë prurjet dhe respektivisht ngarkesën e ndotjes së lartë që gjenerohet, për më tepër edhe gjatë sezonit turistik veror. Niveli i trajtimit i ITUN-eve ekzistuese pjesërisht plotëson kërkesat e Direktivës Evropiane për trajtimin e ujërave të ndotura urbane 91/271/EEC, nëpërmjet së cilës kërkohet mbulim me trajtim të nivelit të dytë, trajtim biologjik, të ujërave të ndotura urbane për të gjitha zonat e banuara me përqendrim të popullsisë më të madh se 2,000 njëvlerës popullsie (PE). Në kuadër të procesit të negocimeve me Bashkimin Evropian është përgatitur plani i investimeve për plotësimin e kërkesave të Direktivës Evropiane për trajtimin e ujërave të ndotura urbane 91/271/EEC, ku në shkallë kombëtare janë planifikuar të ndërtohen të reja 114 ITUN, nga ku 12 ITUN-e duhet të ndërtohen vetëm në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve. Gjithashtu, në kuadër të këtij procesi, në të njëjtat zona duhet të ndërtohet rrjet i ri kolektorësh kanalizimesh për transportin e ujërave të ndotura prej rreth 50 km. Me qëllim përballimin e situatave të vështira të krijuara, doli domosdoshmëri trajtimi i ujërave të ndotura urbane nga vetë subjektet tregtare, në zbatim edhe të parashikimeve në legjislacionin ekzistues në fuqi. Kemi rreth 9000 subjekte që kryejnë aktivitet ekonomik në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve; ujërat e ndotura të shkarkuara në ujëra larëse arritën në nivele të larta, duke përkeqësuar cilësinë e ujërave larëse, rrjedhimisht edhe situata në mjedis dhe shëndetin e popullatës u përkeqësua ndjeshëm. Nisur nga situata e emergjencës mjedisore e krijuar nga subjektet fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitetin ekonomik, duke shkarkuar ujëra të ndotura të patrajtuara në ujëra larëse, doli e nevojshme marrja e masave konkrete nga këto subjekte që të kontribuojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e situatës mjedisore, parandalimin e ndotjes në ujërat larëse dhe mjedisit prej ujërave të ndotura dhe kufizimin e ndikimit kur ajo ndodh nëpërmjet ndërtimit të sistemeve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura të patrajtuara, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo situatë është mbartur ndër vite dhe nuk ka rezultuar në zgjidhje të qëndrueshme nga institucionet inspektuese në vend, ndaj është vlerësuar marrja e masave nëpërmjet nxjerrjes së këtij akti normativ. Për të kuptuar më shumë mbi qëllimin dhe arsyet e miratimit të këtij akti, mund t'i referoheni relacionit të përgatitur nga Këshilli i Ministrave depozituar në Kuvend, i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit dhe që mund ta aksesoni në linkun https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/b1791455-39b3-46fa-841f-59067fce8828...".

Ankuesi, nëpërmjet *email*-it të datës 25.05.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1170/2 prot., datë 25.05.2026 dhe *email*-it të datës 09.10.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1170/3 prot., datë 09.10.2026, ka vijuar ankimin e tij për ankesat nr. 1170 prot., datë 27.04.2026, nr. 1444 prot. dhe nr. 1445 prot., datë 26.05.2026, në vijim edhe të përgjigjes së dërguar nga Autoriteti Publik vetëm ankuesit nëpërmjet *email*-it të datës 04.06.2026, duke parashtruar se: *"...Nëpërmjet ankimit me nr. 43/1 prot., (regjistruar me tuajën ankesa nr. 1170 prot., datë 27.04.2026) kemi kërkuar nga Autoriteti Publik, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, përmbushjen e detyrimit dhe dhënien e informacionit si më poshtë: 1. Në nenin 7 të Aktit Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, parashikohen Detyrat e Task Forcë: "...b) Mbledhjen e informacionit dhe krijimin e një databaze për të dhënat e të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari*

ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të trajtuara dhe të patrajtuara pranë ose në ujërat larëse…" - Sa më sipër, ju lutemi na vini në dispozicion kopje të databazë me të dhënat e të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të trajtuara dhe të patrajtuara pranë ose në ujërat larëse. 2. Në nenin 7 të Aktit Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, parashikohen Detyrat e Task Forcë: "…d) Ushtrimin e kontrolleve për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta, pranë ose në ujëra larëse. Për kryerjen e kësaj detyre Task Forca bashkëpunon me inspektoratet apo strukturat përkatëse që mbulojnë fushën e mbrojtjes së mjedisit, organin që ka licencuar veprimtarinë, inspektoratin sanitar ose inspektoratin bashkiak;… Sa më sipër, ju lutemi na vini në dispozicion informacionin: - A janë kryer kontrolle për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta, pranë ose në ujëra larëse? - Nëse po, në cilat subjekte dhe kur? 3. Në nenin 7 të Aktit Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, parashikohen Detyrat e Task Forcë: "…e) Përgatitjen, në fund të muajit tetor të një raporti për subjektet, për të cilat është marrë masa administrative, sipas këtij akti normativ, dhe propozimin organeve përgjegjëse për heqjen e licencës, të lejes ose të autorizimit për kryerjen e veprimtarisë ekonomike ndaj subjekteve që nuk kanë plotësuar standardet edhe pas vendosjes së masave administrative…". - Sa më sipër, ju lutemi na vini në dispozicion kopje të raportit të mësipërm… Lidhur me këtë ankesë, më datë 04.06.2026, Autoriteti Publik, ndër të tjera, sqaron se: "…Në lidhje me pyetjen rreth mënyrës së ushtrimit të kontrolleve, ju informojmë se kontrollet janë ushtruar në kuadër të kompetencave të ngarkuara me aktin normativ të sipërcituar, mbi bazën e prioriteteve operative, vlerësimit të riskut e nevojave të evidentuara gjatë inspektimeve. Për sa i përket subjekteve të kontrolluara dhe kohës kur ato janë kontrolluar, ju bëjmë me dije se informacioni i kërkuar nuk evidentohet në formën e një dokumenti përmbledhës të veçantë që mund të vihet në dispozicion në kuadër të kësaj kërkese për informacion. Ndërkohë, të dhënat që identifikojnë subjektet konkrete të kontrolluara administrohen në kuadër të veprimtarisë institucionale dhe procedurave administrative përkatëse, ndaj trajtohen në përputhje me rregullat për përdorimin dhe administrimin e tyre…" (bashkangjitur email-it përgjigja datë 04.06.2026), duke refuzuar në këtë mënyrë dhënien e informacionit me pretendimin se nuk gjendet në formën e kërkuar nga ana jonë, ndërkohë informacioni i kërkuar konsiston në informacionin i cili duhet të ishte hartuar nga ana e autoritetit publik në zbatim të dispozitave ligjore… Nëpërmjet ankimit me nr. 45/2 prot. (regjistruar me tuajën ankesa nr. 1445 prot., datë 26.05.2026) kemi kërkuar nga Autoriteti Publik, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, përmbushjen e detyrimit dhe dhënien e informacionit, si më poshtë: 1. Cili ka qenë plani i masave ose planifikimit të kontrolleve në subjektet e kontrolluara gjatë këtij viti (janar shkurt)? 2. Cilat subjekte janë gjobitur? Edhe pas kalimit të afatit të vendosur nga Komisioneri për kthimin e përgjigjes, ende nuk kemi marrë një përgjigje nga Autoriteti Publik… Nëpërmjet ankimit me nr. 46/2 prot., (regjistruar me tuajën ankesa nr. 1444 prot., datë 26.05.2026) kemi kërkuar nga Autoriteti Publik, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, përmbushjen e detyrimit dhe dhënien e informacionit si më poshtë: 1. Kopje të dokumentacionit që ka shërbyer si bazë për marrjen e vendimit për ngritjen e grupit të punës me Urdhrin nr.101, datë 18.10.2023 (propozime, shkresa, analiza paraprake etj.); 2. Lista e plotë e anëtarëve të grupit të punës dhe funksionet e tyre; 3. Kopje të dokumentacionit teknik mbi të cilin është bazuar relacioni që dorëzoi grupi i punës, datë 24.10.2023 (analiza, studime,

raporte, të dhëna statistikore, inspektime në terren, tabela, të dhëna teknike etj.); 4. Në momentin e hartimit të relacionit (datë 24.10.2023), a është bërë një vlerësim i situatës për secilën shoqëri ujësjellës kanalizimesh, nëse disponon apo jo impiant trajtimi dhe, në rastet kur ekziston, cili është kapaciteti i tij funksional? 4. A janë shqyrtuar edhe alternativa të tjera për zgjidhjen e trajtimit të ujërave të ndotura, si p.sh. ndërtimi i impianteve të përbashkëta që mund t'u shërbejnë disa subjekteve njëkohësisht, apo forcimi i sistemit publik ekzistues përmes rritjes së kapacitetit të impianteve (përfshirë edhe mundësinë e kontributit të vetë subjekteve private në këtë drejtim)? 6. A është kryer ndonjë analizë ekonomike apo mjedisore që ka mbështetur zgjedhjen e modelit të impianteve individuale për çdo subjekt? Nëse po, a ekziston një dokument apo vlerësim që trajton ndikimin mjedisor të instalimit të këtyre impianteve në mënyrë të shpërndarë, përfshirë edhe efektin e tyre kumulativ? 7. A ekziston një përkufizim apo kriter i qartë mbi atë se çfarë konsiderohet "subjekt që ushtron aktivitet pranë ujërave larëse"? Në mënyrë më konkrete, cilat janë parametrat (distanca, natyra e aktivitetit, lidhja me sistemin e kanalizimeve etj.) që përdoren për të përcaktuar nëse një subjekt klasifikohet si potencialisht ndotës në këtë kuptim, sipas relacionit? A konsiderohen ujëra larës, ujërat e liqenit të Tiranës, lumi Erzen, lumi Vjosë, lumi i Shalës? 8. A është analizuar përputhshmëria e kësaj ndërhyrjeje me Strategjinë Kombëtare për trajtimin e ujërave të ndotura, të miratuar me VKM-në nr. 448/2023? Nëse po, a ekziston një dokument i shkruar që reflekton këtë analizë? 9. A keni marrë mendimin e specializuar të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura për ndikimin në mjedis të instalimit të impianteve brenda një zone të mbrojtur? 10. Çfarë përfaqëson konkretisht numri prej rreth 9,000 subjektesh të sektorit të hoteleri-turizmit të përmendur në relacion? A i referohet ky numër të gjitha subjekteve të regjistruara në këtë sektor në nivel kombëtar, apo vetëm një nënkategorie të tyre? 11. A disponon grupi i punës një identifikim të saktë të subjekteve që shkarkojnë ujëra të ndotura drejtpërdrejtë në ujërat larëse, pa qenë të lidhur me rrjetin publik të kanalizimeve? Nëse po, cili është numri i këtyre subjekteve? 12. A është kryer një analizë mbi kapacitetin real të këtyre subjekteve (numri i shtretërve, fluksi sezonal, volumet e ujërave të ndotura të gjeneruara), si dhe mbi ndikimin konkret që ato kanë në ndotjen e ujërave larëse? 13. Gjithashtu, a është analizuar veçmas kapaciteti ndotës i subjekteve të lidhura me rrjetin publik të kanalizimeve, duke pasur parasysh se këto subjekte i nënshtrohen trajtimit kolektiv të ujërave urbane nga sistemi publik? 14. Nëse këto analiza janë kryer, lutemi të na vihen në dispozicion studimet, të dhënat dhe metodologjitë përkatëse mbi të cilat është mbështetur relacioni. Në të kundërt, lutemi të sqaroni mbi çfarë baze faktike dhe teknike janë arritur përfundimet e paraqitura në këtë dokument. 15. Duke iu referuar kuadrit rregullator ekzistues për trajtimin e ujërave të ndotura, në veçanti dallimit të bërë ndërmjet shkarkimeve industriale dhe atyre urbane, ku për këto të fundit parashikohet trajtim përmes sistemit publik të kanalizimeve dhe impianteve kolektive,: - Si është reflektuar ky dallim në analizën e grupit të punës dhe në përfundimet e relacionit, në kushtet kur ndërhyrja e propozuar orienton drejt instalimit të impianteve individuale edhe për subjekte që prodhojnë ujëra urbane dhe janë të lidhura me sistemin publik? - Gjithashtu, a është vlerësuar në këtë kontekst nëse kjo qasje përbën një devijim nga modeli i trajtimit kolektiv i parashikuar në legjislacionin në fuqi dhe, nëse po, mbi çfarë baze teknike apo mjedisore është justifikuar ky ndryshim? 16. VKM nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të

mjediseve ujore pritëse" parashikon mënyrën e monitorimit dhe vendin e monitorimit ku konkretisht për veprimtaritë industriale (Kreu II) monitorimi bëhet para se ujërat të futen në sistemin publik të kanalizimeve. Ndërsa për ujërat urbane, standardet e ndotjes maten dhe duhen përmbushur pasi ujërat janë mbledhur nga sistemi publik i kanalizimeve dhe përpara se të shkarkohen në trupat ujore pritëse (Kreu III). Duke pasur parasysh këtë parashikim ligjor: - Si është parashikuar të realizohet në praktikë monitorimi i cilësisë së ujërave të ndotura në rastin e impianteve individuale të shpërndara, në kushtet kur ky model krijon një numër shumë të madh pikash të vogla shkarkimi, për të cilat nuk rezulton të jetë përcaktuar një metodologji e qartë monitorimi në kuadrin rregullator ekzistues? - Kopje të listës së subjekteve të kontrolluara deri më tani dhe kriteret mbi të cilat janë përzgjedhur këto subjekte... Edhe pas kalimit të afatit të vendosur nga Komisioneri për kthimin e përgjigjes, ende nuk kemi marrë një përgjigje nga Autoriteti Publik. Gjendur në këto kushte, kërkojmë vijimin e ankesave kundër Autoritetit Publik, Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve, dhe detyrimin e tij për të dhënë informacionin e kërkuar sipas objektit të kërkesave. Konkretisht, kërkojmë vijimin e ankesave: ankesa me nr. 1170 prot., datë 27.04.2026 (lidhur me kërkesën nr. 43/26), ankesa me nr. 1445 prot., datë 26.05.2026 (lidhur me kërkesën nr. 45/26), ankesa me nr. 1444 prot., datë 26.05.2026 (lidhur me kërkesën nr. 46/26)…".

Pas vijimit të ankuesit, Autoriteti Publik nuk ndërmori asnjë masë për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Pas shqyrtimit të objektit të ankimeve dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të LDI-së, sipas së cilës: *"'"Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik"*.

Për sa i përket pretendimit të Autoritetit Publik se një pjesë e dokumentacionit nuk mund të jepet pasi përmban të dhëna personale në kuptim të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ky pretendim i autoritetit nuk qëndron, pasi neni 5 i ligjit të sipërcituar, në pikën 3 të tij parashikon se: "*...E dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash...*", dhe në pikën 23 të tij parashikohet se: "*...Subjekt i të dhënave është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror...*". Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 44 të tij parashikohet se: *"...Aksesi i publikut në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, dhe aksesi i publikut në informacionin që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar rastesh...."*.

Bazuar në nenet 66 dhe 67 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", të ndryshuar, të dhënat e regjistruara në regjistrin tregtar dhe ekstraktet përkatëse janë të aksesueshme për publikun, me përjashtimet e parashikuara në këtë ligj. Ky parashikim lidhet me të dhënat e regjistrit tregtar dhe nuk përcakton vetvetiu aksesin në informacionin për kontrollet ose masat administrative ndaj subjekteve. Këto të dhëna duhen vlerësuar veçmas, sipas kufizimeve të nenit 17 të LDI-së dhe interesit publik për informimin mbi kontrollet në fushën e mbrojtjes së mjedisit, informacion i cili, përveç parashikimeve të LDI-së, për shkak të sensibilitetit dhe impaktit të lartë në shoqëri, garantohet në mënyrë të posaçme nga konventa "Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendim marrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin" (*Konventa e Aarhusit*), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000.

Për sa më sipër, duke u bazuar në ligjin e sipërcituar dhe në ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", emrat e subjekteve tregtare, të cilat janë subjekt i kontrollit të tij, siç vetë është pohuar nga Autoriteti Publik në përgjigjen e tij (...*Task Forca pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve kryen kontrollet ndaj subjekteve të bazuar në programin periodik dhe mujor të inspektimit të hartuar në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit nr. 65, datë 19.04.2024*...), nuk gëzojnë mbrojtje dhe, si rrjedhojë, publikimi i tyre nuk cenon asnjë dispozitë të ligjeve të sipërpërmendura.

Lidhur me kërkesën për listën e anëtarëve të grupit të punës dhe funksionet e tyre, këto të dhëna, për anëtarët që kanë ushtruar detyrën në cilësinë e funksionarëve ose punonjësve publikë, lidhen me kryerjen e funksioneve zyrtare. Në këto kushte, aksesi në to nuk mund të refuzohet vetëm me arsyetimin se përbëjnë të dhëna personale, në kuptim të pikës 2 të nenit 44 të ligjit nr. 124/2024. Gjithashtu, kërkuesi nuk ka detyrim të shpjegojë motivet e kërkesës për informacion, sipas pikës 1 të nenit 3 të LDI-së. Nëse dokumentacioni përmban të dhëna të tjera personale që nuk lidhen me funksionin zyrtar, ato mund të kufizohen veçmas, duke vënë në dispozicion pjesën tjetër të dokumentit.

Lidhur me pretendimin e Autoritetit Publik, se disa dokumentacione nuk i disponon në mënyrën apo formatin e kërkuar nga ankuesi, pika 2 e nenit 14 të LDI-së parashikon shprehimisht se: "...*Kërkesat që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuesit: a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta; b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet*...." dhe pika 3 e nenit 14 të LDI-së parashikon se: "...*Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik*...".

Informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar nga Autoriteti Publik. Detyrimi për vënien në dispozicion shtrihet mbi informacionin që Autoriteti Publik zotëron. Për informacionin që nuk zotërohet, autoriteti duhet të njoftojë kërkuesin dhe të zbatojë procedurën e parashikuar në nenin 12 të LDI-së.

Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI-së, ku përcaktohet se: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".*

Bazuar në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së, parashikohet se: *""Autoritet publik" është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj".*

Në kuptim të këtij parashikimi, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1, përcakton se: *"1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike".* Në këtë kuptim, çdo autoritet publik, pavarësisht nëse është në cilësinë e "prodhuesit" apo "mbajtësit" të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Si përfundim, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI-së: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".*

Gjithashtu theksohet se informacioni/dokumentacioni i kërkuar nga ankuesi lidhet ngushtësisht me ndërhyrjet infrastrukturore në trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen në ujëra larëse dhe impaktin e veprimeve apo mosveprimeve të Autoritetit Publik në parandalimin e ndotjes së ujërave larëse, fakt i cili ka një impakt të menjëhershëm në mjedis dhe si informacion/dokumentacion i tillë e drejta për t'u informuar garantohet edhe nga konventa "Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendim marrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin" (*Konventa e Aarhusit*), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000, e cila në nenin 4, pika 1, parashikon se: *"Çdo palë do të sigurojë që, në përputhje me paragrafët e mëposhtëm të këtij neni, autoritetet publike, në përgjigje të kërkesës për informacion mjedisor, ta bëjnë informacionin të disponueshëm, brenda kuadrit të ligjit kombëtar, përfshirë kopje të dokumentit aktual që përmban këtë informacion në rastet kur kërkohet dhe sipas nënparagrafit "b" më poshtë: Pa qenë nevoja për të deklaruar interesin për këtë informacion. Në formën e kërkuar në qoftë se: Nuk është e arsyeshme për autoritetet publike që ta bëjnë atë të disponueshëm në një formë tjetër dhe në këtë rast ato do të japin arsyet përse e kanë bërë të disponueshëm në*

atë formë; ose informacioni nuk është ndërkohë i disponueshëm për publikun në një formë tjetër". Ndërsa, në pikën 2 të nenit të sipërcituar shprehet se: *"Informacioni mjedisor, referuar në paragrafin 1 më lart, do të bëhet i disponueshëm sa më shpejt që të jetë i mundur, por jo më vonë se një muaj pas paraqitjes së kërkesës, nëse volumi dhe kompleksiteti i informacionit e justifikon zgjatjen e kësaj periudhe deri në dy muaj pas kërkesës. Kërkuesi i informacionit do të informohet për çdo shtyrje të afatit kohor dhe për arsyet që justifikojnë këtë shtyrje".*

Në vlerësimin e interesit publik për informimin merret parasysh se ankuesi është organizatë jofitimprurëse, që synon të informojë publikun për çështje që lidhen me funksionimin e autoriteteve publike dhe mbrojtjen e mjedisit. Në çështjen *Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë*, nr. 37374/05, datë 14.04.2009, GJEDNJ ka vlerësuar se një OJF që kontribuon në debatin publik mund të ushtrojë rolin e "mbikëqyrësit shoqëror", të ngjashëm me atë të medias (§ 27), dhe se pengesat në aksesin në informacion me interes publik mund të cenojnë këtë rol dhe aftësinë për t'i ofruar publikut informacion të saktë e të besueshëm (§ 38). Ky vlerësim mbështet peshën e interesit publik në rastin konkret, pa e bërë statusin ose motivin e ankuesit kusht për ushtrimin e së drejtës për informim.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, si dhe shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankesave të qendrës "Res Publica", përfaqësuar nga z. , me nr. 1170 prot., datë 27.04.2026, nr. 1444 prot. dhe nr. 1445 prot., datë 26.05.2026, ndaj Autoritetit Publik "Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit sipas kërkesave për informacion me nr. 43/26 prot., nr. 45/26 prot. dhe nr. 46/26 prot., datë 27.03.2026, sipas objektit të përmendur më sipër në këtë vendim, brenda datës 20.11.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6 të nenit 17 dhe pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 13.11.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi